

# Rend shtëpiak

Ekstrakt

## ***Koha e qetësisë***

Qetësia e përgjithshme shtëpiake: nga **ora 12:00 - 15:00** dhe  
nga **ora 22:00 - 8:00**

Punimet në shtëpi me zhurmë intensive (p. sh. shpuarja, trokitja me çekiç, shkundja e qilimave) janë të lejuara:

Të hënën – të shtunën nga **ora 8:00 - 12:00** dhe  
Të hënën – të premten nga **ora 15:00 - 19:00**

Të dielave dhe ditëve të festave nuk guxon të përdoret vendi për tharjen e rrobave.

Vendosja e sendeve në treme, korridore dhe shkallë nuk është e lejuar. Këtu bëjnë pjesë p. sh. biçikletat, rolerët për fëmijë, trerrotëshat, sajat, karrocet për fëmijë, ormanet, saksitë e luleve, këpucët etj.

Lojrat me top, sidomos futboli dhe basketboli, janë të lejuara vetëm në vendet e parashikuara për to.

Qëndimi i panevojshëm në hollet e hyrjes, nëpër shkallë, në korridore të bodrumit dhe të kateve është i ndaluar.

## ***Pastërtia dhe rendi***

Ndotjet e sendeve dhe ndyrësitë në parkun e banesave duhet të menjaherë menjëherë nga shkaktari.

Mbeturinat e çdo lloji nuk guxojnë të hedhen në nevojtoret.

Mbi parrmakët e ballkonit nuk guxohen të vendosen sende për ajrosje apo pastrim.

Shkundja e fshesave, pecetave të pluhurit, qilimave, mbulesave të krevatit etj. nga ballkoni apo nga dritarja nuk është e lejuar.

Pjekja në skarë në ballkon është e ndaluar.

Hedhja dhe ndezja e fishekzjarreve në shtëpi dhe në ballkon është rreptësisht e ndaluar.

Deponimi i karburanteve si dhe vendosja dhe riparimi i automjeteve me motor brenda ndërtesës së banimit është i ndaluar. Në truallin dhe në garazhet e »Wohnstätten« janë të ndaluara riparimet e automjeteve të çdo lloji.

Çatmatë prej dërrasave (në bodrume dhe ballkone) nuk guxojnë të mbyllen apo të zihen.

Java e fshirjes është e rregulluar në kontratën e qirasë. Ajo fillon gjithmonë të hënën në mëngjes dhe mbaron të dielën në mbrëmje. Sipas nevojës punët e pastrimit duhet të kryhen edhe disaherë gjatë periudhës së javës së fshirjes.

Rendi shtëpiak është pjesë përbërëse e kontratës së qirasë.

Shkelja e disahershme kundër rendit shtëpiak mund të sjellë deri te largimi nga banesa!!!

Sindelfingen, më 9 qershor 2004